



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike  
Mbledhja nr. 15  
Prishtinë, më 28 mars 2018, në orën 11:00  
Ndërtesa e Kuvendit, Salla C-203-

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Driton Selmanaj, Albert Kinolli, Avdullah Hoti, Shqipe Pantina, Lumir Abdixhiku, Dardan Mulliqaj, Enver Hoti, Naser Osmani, Blerim Kuçi dhe Safete Hadërgjonaj.

**Munguan:** Faton Topalli, Ali Lajçi, Mërgim Lushtaku, Andin Hoti, Muharrem Nitaj, Zafir Berisha dhe Verica Çeraniq.

**Stafi mbështetës i komisionit:** Mehmet Simnica.

**Pjesëmarrësit tjerë:** Bedri Hamza dhe Lulzim Rafuna nga MF; Rejhane Zulfaj dhe Mentor Hyseni nga GIZ; Bujar Bajraktari dhe Safet Berisha, ZKA.

**Mbledhjen e kryesoi:** Driton Selmanaj kryetar i KMFP-së dhe Lumir Abdixhiku, kryetar i KBF-së.

**Rendi i ditës:**

**Raportim i ministrit të Financave, z. Bedri Hamza, lidhur me shpenzimet e paparashikuara për vitin 2018.**

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit, e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Raportim i ministrit të Financave, z. Bedri Hamza, lidhur me shpenzimet e paparashikuara për vitin 2018**

**Kryesuesi** njoftoi deputetët dhe të pranishmit, se sot është ftuar në takim ministri i Financave, z. Bedri Hamza, për të raportuar sa i përket shpenzimeve të ndodhura, nga programi shpenzimet e paparashikuara dhe rezerva për 3 mujorin e parë të vitit 2018. Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, mbledhje të përbashkët. Me këtë hapi diskutimin.

Ministri Hamza, lidhur me këtë, në fillim të fjalës së tij, bëri të ditur se mënyra e shpenzimeve të rezervave buxhetore të shtetit, është kritikuar nga vetë ai dhe vlerësoi se, shpenzimet e financuara nga rezerva shtetërore, është dashur të përfshihen në shpenzimet e rregullta, e të parashihen në Ligjin e buxhetit. Duke iu referuar të dhënave statistikore të shpenzimeve nga rezervat shtetërore për vitet paraprake, ministri Hamza bëri të ditur se ato nuk dallojnë shumë nga shpenzimet e këtij viti, ndërkaq pohoi se shpenzimet e gjertanishme nuk rrezikojnë stabilitetin makro-financiar në vend. Shpenzimet më të mëdha, sqaroi më pas Hamza, janë evidentuar gjatë shënimit të datave të rëndësishme shtetërore, si dhe shpenzime të tjera, siç janë ndihmat për komunitete dhe shpenzime të tjera që nuk kanë qenë të përfshira në Ligjin e buxhetit. Ndër shpenzimet më të mëdha, e që nuk kanë qenë të parapara, sqaroi ministri Hamza, kanë qenë investimet në KOST. Lidhur me këtë, sqaroi se problemet që e përcjellin KOST-in janë shumë të mëdha dhe do të shkaktojnë shpenzime edhe në të ardhmen. Sipas tij, zgjidhja afatgjate e problemeve në KOST është zbatimi i marrëveshjes për energjinë nga ana e Serbisë, e arritur gjatë procesit të dialogut me Kosovën në Bruksel. Në vijim të takimit, ministri i Financave Hamza, u është përgjigjur edhe pyetjeve të anëtarëve të komisioneve, ndërkaq kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, si dhe kryetari i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, Driton Selmanaj, kërkuan nga ministri dhe kabineti qeveritar, përkushtim edhe më të madh për tejkalimin e problemeve në KOST.

**Driton Selmanaj**, theksoi se vetëm për 2 muaj e gjysmë, ju keni shpenzuar mbi 50% të rezervës, prandaj dëshirojë të pyes, bazuar në ndarjen buxhetore për vitin 2018, sipas Ligjit të buxhetit 06/L-020, në kuadër të shpenzimeve të paparashikuara janë ndarë mjete në shumën prej 4.8 milionë euro. Sa është shuma e mjeteve të shpenzuara deri më sot, si dhe sa nga këto mjete të shpenzuara kanë miratimin e ministrit të Financave, në bazë të autorizimit të dhënë?

A mendoni se me proces të rishikimit të buxhetit apo me procese të ardhshme të lëvizjeve në buxhet, të alokoni mjete për mbushjen e programit, shpenzimet e paparashikuara dhe rezerva?

Me rastin e planifikimit të buxhetit për vitin 2018, me rastin e buxhetimit për këtë program, a ka pasur ndonjë ide se për çka mund të përdoren këto mjete për vitin 2018, cilat ishin planet për pagesa nga ky program? Zbrazja e këtij fondi në bazë të vendimeve të Qeverisë apo edhe në bazë të vendimit të vetë ministrit të Financave, në bazë të autorizimit që ka me ligj. A kanë mundur të planifikohet më mirë nga ana e organizatave buxhetore, kërkesat për buxhet se sa të kërkohet të alokohen mjete nga shpenzimet e paparashikuara, që është i dedikuar për shpenzime emergjente? Sa ishin shpenzimet në total për këtë program (Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat) për vitin 2017 dhe a kanë mbetur obligime që kanë mundur të paguhen nga ky program deri në fund vitit 2017? Po ashtu, kërkoi nga ministri i Financave që t'i sigurojë të dhënat për të gjitha shpenzimet e ndodhura në emër të këtij fondi për vitin 2017, si dhe të gjitha pagesat e bëra për janar dhe shkurt 2018. Pra, thënë shkurt, pse nuk ka pasur plane paraprake për këtë? Po ashtu,

pyeti se shumë e mjeteve prej 350,000 euro, e ndarë për rastin Kumanova, nga cili program janë ndarë?

**Shqipe Pantina**, theksoi se edhe viteve të kaluar rezervat janë përdorur për nevoja të cilat kanë mundur të planifikohen me buxhet të rregullt. Këtë vit nuk kemi pasur gjendje emergjente, por në disa raste, kemi pasur vërshime apo dëme të shkaktuara nga erërat e forta. Për këto dëme, komunat nuk kanë buxhet që mund për t'i mbuluar shpenzimet e caktuara. A keni menduar për këtë se si mund të paguhet këto dëme? Po ashtu, pyeti se në KMFP është diskutuar disa herë niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve nga ana e institucioneve, si dhe përsëritja e të gjeturave nga ana e këtyre institucioneve nga viti në vit. Cili është mendimi juaj për këtë?

**Albert Kinolli**, tha se a ekziston mundësia të ndahet një kod i veçantë, në kuadër të Ministrisë së Komuniteteve, për sa i përket mjeteve që ndahen në emër të komuniteteve. Po e them këtë se gjatë ekzekutimit të buxhetit nuk po janë përfitues komunitete tjera jo serbe. Prandaj, do të ishte shumë parimore të krijohet një program i veçantë, në kuadër të këtij institucioni dhe të dihet saktë sa mjete po shkojnë në emër të komuniteteve pakicë. Po ashtu, përmendi rastin e MPMS-së, sa i përket ndërtimit të qendrave për banim social për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas, si veprim i mirë i Qeverisë.

**Lumir Abdixhiku**, propozoi t'i jepet rekomandim Qeverisë së Republikës së Kosovës, sa i përket gjetjes së një zgjidhjeje për problemin e rrymës që nuk po paguhet nga komunitete.

#### *Përfundim*

*KMFP dhe KBF, vendosën që t'i rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, për të bërë gjetjen e një zgjidhjeje të qëndrueshme, sa i përket pagesës së energjisë elektrike, me qëllim që në të ardhmen, rezervat e Qeverisë mos të përdoret për qëllime të tilla.*

*Mbledhja përfundoi në orën 12:15.*

**E përgatiti:**  
**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**  

---

**Driton Selmanaj**